Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) garanci bankare
- b) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
 - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
 - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
 - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
 - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kriteve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit: _____

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>6</i>	
Artikulli	Përshkrimi i shërbimit	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total për shërbim (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total (Mallrat)				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					

Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Argumentimi: Specifikimet Teknike të mësipërme janë në përputhje me nenet: Neni 4, pika 38/b të LPP, si dhe nenit 40, pika 2; 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Theksojmë se 'Specifikimet Teknike' i shërbejnë AK për të patur garanci se malli i ofruar do të jetë në parametrat dhe në cilësinë e duhur.

Shënim: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

Specifikime Teknike

Sigurimi i kullës së kontrollit mobile në Aeroportin e Kukësit me gjithë pajisjet e nevojshme

PËRMBAJTJA

Regjistrimi i Ndryshimeve të Dokumentit.....	Gabim! Shenja e referimit e padefinuar.
PËRMBAJTJA	38
Hyrje	38
Konfidencialiteti.....	39
1. Të Përgjithëshme	39
1.1 Gama e Furnizimit.....	40
2. Kërkesat teknike për Kullen dhe sistemet perberese te saj.....	40
2.1. Kërkesa teknike per pjesen kabines se kullës.....	40
2.2. Kërkesa teknike per Sistemet ATC te perfshira ne kulle	42
2.3 Pjeset Rezerve.....	44
3. Shërbimet.....	44
3.1. Instalimi dhe Komisionimi i Kullës	44
3.2. Mirembajtja e Kullës.....	44
3.3. Suporti nga prodhuesi	44
Shtojca A: Lista e paisjeve dhe shërbimeve	45

Hyrje

Ne kuader te ofrimit te shërbimeve ATS AFISO dhe CNS ne Aeroportin e Kukesit lindin nevojat per marrjen me qera te infrastruktures CNS sipas Plan Biznesit te Kompanise dhe vendimit Menaxherial.

Aktualisht ne kete Aeroport eshte duke operuar ne po te njejtin model biznesi, nje Kulle Mobile me te gjitha pajisjet CNS te nevojeshme per ofrimin e ketij shërbimi. Ne kete rast Albcontrol do te shfrytëzoje sistemet CNS te instaluarat per te plotësuar kerkesat e Divizionit Operacional nga i cili ka marre dhe kerkesat e nevojeshme per kete kulle.

1. Konfidencialiteti

I gjithë Informacioni i marrë nëpërmjet kësaj procedure është pronë e Albcontrol dhe ofertuesit nuk mund ta përdorin apo shpërndajnë tek të tretë përveçse për nevojat e përmbushjes dhe plotësimit të ofertës së tyre.

Po kështu oferta e dorëzuar në Albcontrol do të trajtohet si konfidenciale dhe nuk do të shpërndahet tek të tretë jashtë Albcontrol-it.

1. Të Përgjithëshme

Ne permbajtje te ketij dokumenti Specifikimeve Teknike, Albcontrol duhet të sigurojë vijueshmërinë e punës, ritjen e performancës së tij, ruajtjen e nivelit të SAFETY dhe plotësimin e standarteve të ICAO-s , EASA në Aeroportin e Kukesit. Kompania do te ofroje sisteme Certefikuara nga Prodhues te njohur Europiane se bashku me dukumentat perkates te Interoperabilitetit, Declaration of Conformity. Ofruesi i Infrastruktures TWR Kukes duhet te ofroje gjithashtu nje sasi te nevojeshme pjese rezerve te depozituara ne site (LRU, local unit replacment) e cila do te zvogeloje kohen e sjelljes ne pune ne rast defektesh.

Ne zera kerkesash parashikohet te ofrohet sa me poshte:

- 1 Furnizim TWR e cila do merret me qera me te gjitha sistemet e kerkuara ne listen e detajuar ne brendesi te ketij dokumenti.
- 2 Furnizim pjesesh rezerve te ruajtura ne Site.
- 3 Instalim dhe komisionim i Kulles dhe pjeseve perberese te saj.
- 4 Mirembajtja e pjeseve elektro – mekanike., kondicionim dhe sistemi i zjarrit per periudhen e marrjes me qera.
- 5 Suport nga prodhuesit e sistemeve CNS, VHF Radio A-G, Central Telefonik, Crash Phone gjate integrimin te sistemeve me sistemet aktuale te Albcontrol.

1.1 Gama e Furnizimit

Ofertuesit do të ofrojnë shërbimet si vijon:

A- Hardware

- 1 Furnizim TWR me të gjitha sistemet e kerkuara ne listen e detajuar ne brendesi te ketij dokumenti.
- 2 Furnizim pjesesh rezerve te ruajtura ne Site.

B- Sherbime

- 1 Instalim dhe komisionim i Kullës dhe pjesëve të saj.
- 2 Mirembajtja e pjesëve elektro – mekanike., kondicionim dhe sistemi i zjarrit.
- 3 Suport nga prodhuesit e sistemeve CNS, VHF Radio A-G, Central Telefonik, Crash Phone gjatë integritit të sistemeve me sistemet aktuale të Albcontrol.

2. Kërkesat teknike për Kullën dhe sistemet perberese te saj

2.1. Kërkesa teknike per pjesen kabines se kullës

Nr i specifikimit	Specifikimi
2.1.1	Kulla duhet te jete e ndertuar ne container i cili te jete vendosur mbi nje trailer si dhe e paisur me ngrites hidraulik sidhe sistem bllokimi te ngritjes kur kulla pozicionohet per perdorim.

<p>2.1.2</p>	<p>Kulla duhet te jete e ndertuar ne formen e nje containeri ISO-1C dhe.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Paretet dhe catia duhet te jene te ndertuara me material qe absorbon zhurmat 2- Catia duhet te kete pozionet e duhura per montimin e Antenave te Radiove VHF 3- DysHEMEJA duhet te jete antistatike
<p>2.1.3</p>	<p>Kulla duhet te kete:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Ballkon i cili duhet te kete edhe pozicionimin e shkalleve per tu ngjitur ne kulle 2- Duhet te kete shkalle te cmontueshme te cilat vendosen vetem gjate perdorimit te kules.
<p>2.1.4</p>	<p>Dritaret e Kules duhet te kene karakteristikat si me poshte</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Te kene mundesi qe te mbulohen gjate transportit. 2- Xhami i perorur duhet te jete qe te duroje zhurmat e nivelit te shpertimeve si dhe te kete mbrojtje nga papastertite si dhe njollat e krijuara nga pikat e ujit 3- Dritaret duhet te jene te paisura me perde
<p>2.1.5</p>	<p>Consola brenda ne kulle:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Konsola duhet te suportojte deri ne 2 poste pune per Kontrollore 2- Duhet te kete vendet e nevojshme per montimin e paisjeve ATC ne formatin 19” 3- Duhet te kete dy karrike te levizeshme 4- Ore digitale per te shfaqur oren ne UTC 5- Ore digitale per te shfaqur oren lokale.
<p>2.1.6</p>	<p>Ndricimi i kules</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Kulla duhet te jete e paisur me ndricim te brendeshem me ngjyra per tu perdorur ne varesi te kohes dhe situates. <ol style="list-style-type: none"> a- Ndricim Natyral b- Ndricim blu per naten c- Ndricim Emergjent d- Ndricim i jashtem 2- Gjithastu kulla duhet te jete e paisur me ndricim per te treguar lartesine (Obstruction Light)
<p>2.1.7</p>	<p>Furnizimi me Energji i Kules:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Kulla duhet te kete mundesi te furnizohet me tension 3 fazor 400V 2- Duhet te kete panel shperndarje te energjise te paisur me Mbrojtresa diferenciale dhe magnetotermike 3- Kulla duhet te kete nje UPS ic ili duhet te mbaje paisjet ATC ne gjendje pune per nje periudhe kohore jo me te vogel se 1 ore.

2.1.8	<p>Mbrojtaj dhe siguria e kullës</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Kulla duhet të jetë e pajisur me sistem rrufepritesi dhe me kabllimet dhe pjesët perberese të rrufepritesit 2- Duhet të jetë e pajisur me sistem dedektimi të zjarrit dhe Alarm 3- Duhet të ketë Shuares të zjarrit.
2.1.9	<p>Pajisje të tjera që duhet të ketë kulla:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Kondicionim të Kontainerit 2- Light Gun 3- Kuti të ndihmës së shpejte
2.1.10	<p>Konsola e kullës duhet të ketë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Ekranë me ndricim të lartë për të shfaqur të Dhenat e ATC si AFTN AWOS etj. 2- Duhet të jetë e pajisur me ndricim lokal në çdo post i komandueshem dhe dimmerueshem
2.2. Kërkesa teknike për Sistemet ATC të përfshira në kullë	
2.2.1	<p>Sistemi i komunikimit A_G dhe G-G (Postet e Punës):</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Kulla duhet të jetë e pajisur me dy poste pune për kontrollorë për komandimin dhe përdorimin e komunikimeve A-G dhe G-G 2- Komunikimet A-G dhe G-G duhet të komandohen nëpërmjet ekraneve touch me madhësi 10” 3- Nga këto ekrane kontrollori do të ketë mundësi të selektojë radion VHF që mund të përdoret si dhe të realizojë thirrjet telefonike 4- Panelet duhet të kenë mundësi të lidhen me radiot VHF lokale në kullë nëpërmjet protokollit VOIP 5- Panelet duhet të kenë mundësi të lidhen me Albcontrol (Rinas Tirane) nëpërmjet protokollit SIP. 6- Postet e punës duhet të jenë të pajisura me altoparlante si dhe fisha për të përdorur kufje gjatë komunikimit.
2.2.2	<p>Sistemi i komunikimit A_G dhe G-G (Radiot VHF):</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Kulla duhet të jetë e pajisur me minimumi ka Radio TRX në bandën VHF të Aviacionit. 2- Radiot duhet të suportojnë protokollin SIP (ED137B) për të lidhur me Postet e punës si dhe për të pasur mundësi të lidhen dhe komandohen remote nga Rinas. 3- Radiot duhet të jenë të pajisura me antenat e veta të cilat duhet të jenë të montuara në catinë e kullës. 4- Kulla duhet të ketë dhe një radio TRX stand alone për rastet emergjente kur konsola nuk është funksionale. Kjo radio duhet të ketë furnizim të vecantë me ushqim dhe bateri.

<p>2.2.3</p>	<p>Sistemi i komunikimit A_G dhe G-G (Crash Phone):</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Kulla duhet te jete e paisur me nje sistem te pavarur per njoftimin e zjarrefikesve dhe Menaxhimit te Aeroportit ne rast te Incidenteve ne Aeroport. 2- Sistemi Crash Phone duhet te jete i paisur me setin e kules dhe setin e zjarrefikesve si dhe komunikimi mes kules dhe zjarrefikesve do te behet nepermjet linjave telefonike egzistuese. 3- Ku sistem ne stacionin e zjarrefikesve duhet te jete i paisur me nje sirene dhe boxe per te dhene alarm ne momentin kur Kontrollori do te njoftoje perincidente.
<p>2.2.4</p>	<p>1-</p>
<p>2.2.5</p>	<p>Sistemi i regjistrimit zanor</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Kulla duhet te jete e paisur me nje sistem regjistrimi te komunikimeve zanore. 2- Ky sistem duhet te kete mundesine e ruajtjes se informacionit audio per nje periudhe jo me te vogel se 30 dite 3- Sistemi duhet te kete mundesine qe te aksesohet remote nga Qendra e Albcontrol (Rinas) 4- Sistemi regjistrimit duhet te regjistroje radiot VHF, Telefonine,crash phone dhe Radion e emergjences.
<p>2.2.6</p>	<p>Sisteme te tjera:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Kulla duhet te kete nje monitor min 19”per te shfaqur te dhenat meteorologjike nga sistemi AWOS 2- Keto monitore duhet te jene te montuar ne konsolle dhe vete konsola duhet te kete hapsire per te montuar kompjuterat e ktyre sistemeve ne te.
<p>2.2.7</p>	<p>Sistemi Meteorologjik portabel per matjen dhe vizualizimin e parametrave te eres, drejtimit, forces, temperatures, presionit atmosferik.</p> <p>Sistemi duhet te jete me certefikate kalibrimi apo i disenjuar per autokalibrim ne baze te nje procedure te deklaruar qe kryhet nga Kontraktori.</p>
<p>2.2.8</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1- Pajisje Networku Ethernet 2- 1x Router Cisco ISR4331/K 3- 2x Switch Layer 2 Cisco 24 porta + PoE 4- Patch pannel per terminim lidhje fiber Optike minimumi 12 Porta SC APC.

2.3 Pjeset Rezerve	
2.3.1	<p>1- Kontraktori/prodhuesi duhet te furnizojë në kullë dhe pjesët rezerve të nevojshme për sistemet e përfshira në kullë</p> <p>2- Pjesët rezerve duhet të përfshihen të gjitha sistemet që janë pjesë përbërëse të kullës duke filluar nga pjesët elektromekanike deri tek pjesët për sistemet e ATC</p>

3. Shërbimet	
3.1. Instalimi dhe Komisionimi i Kullës	
2.3.1	<p>Kontraktori duhet të realizojë pozicionimin e kullës në vendin e caktuar si dhe instalimin e saj.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Duhet të sigurojë dhe kryejë lidhjen elektrike me rrjetin elektrik të aeroportit 2- Duhet të sigurojë dhe kryejë lidhjen e linjave telefonike dhe të dhenave që vijnë nga jashtë kullës. 3- Duhet të kryejë instalimin e plote të të gjitha pjesëve përbërëse të kullës si Antena, Obstruction Light dhe Mbrojtjen nga rrufetë.
2.3.2	<p>Kontraktori mbas instalimit duhet të bëjë komisionimin e saj ku duhet të testohen sistemet përbërëse të saj:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Testimin e sistemit elektro mekanik 2- Testimin e sistemit elektrik 3- Testimin e sistemeve ATC (Sistemet A-G, G-G, Regjistruar etj)
3.2. Mirembajtja e Kullës	
3.2.1	<p>Kontraktori duhet të keshillojë dhe realizojë mirembajtjen periodike të pjesëve mekanike dhe elektromekanike të kullës</p>
3.2.2	<p>Gjatë periudhës së mbajtjes me qera të kullës kontraktori duhet të kryejë shërbime periodike të mirembajtjes së sistemeve si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1- Sistemit Elektrik të kullës dhe UPS, 2- Sistemin e kondicionimit 3- Sistemin e mbrojtjes nga zjarri, 4- Gjendjen fizike të konteinerit
3.2.3	<p>Për çdo mirembajtje që do të kryhet nga Kontraktori mbas kryerjes së saj ai duhet të paraqesë një raport të detajuar të mirembajtjes</p> <p>Ky raport do të ketë një format të caktuar dhe për formatin do të bëhet dakort me stafin teknik të Albcontrol</p>
3.3. Suporti nga prodhuesi	
3.3.1	<p>Kontraktori duhet të sigurojë suportin e prodhuesit për të gjithë sistemet ATC përbërëse të kullës.</p>

3.3.2	Gjate instalimit dhe komisionimit Kontraktori duhet te siguroje suportin nga prodhuesi per sistemet ATC. 1- Suporti duhet te perfshije personel ne stacion ose remote i cili do te ndihmoje ne integrimin e sistemeve te kullës me sistemet egzistuese te Albcontrol
3.3.3	1- Kontraktori eshte pergjegjes per mbajtjen ne pune te sistemeve COM ne terresi duke garantuar suportin nga prodhuesit dhe nje sasi te nevojeshme pjese rezerve per te suportuar qellimin per sistemet qe do te vendosen ne dispozicion si pjese kontrates se qeramarrjes.
3.3.4	Nje trajnim On Job Training ose remote duhet te ofrohet nga Prodhuësi i Sistemeve te komunikimit A-G per stafin ATSEP COM te Albcontrol me qellim rivendosjen ne pune te sistemit ne rast defektesh. Ky trajnim duhet te shoqerohet me certifikate pjesemarrje.

2. Shtojca A: Lista e paisjeve dhe shërbimeve

Nr.	Pershkrimi pjeseve/sherbimeve	Njesia	Sasia	Koha e kryerjes
A	Kulla me qera			
1	Kulla dhe sistemet COM dhe MET me qera	Muaj	12	
3	Mirembajtje pjeseve elektro – mekanike.	Periodik	4	
4	Suport nga Prodhuëset e Sistemeve CNS gjate integrimin dhe kohes se Operimit	cope	1	

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Sigurimi i kullës së kontrollit mobile në Aeroportin e Kukësit me gjithë pajisjet e nevojshme”

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Sigurimi i kullës së kontrollit mobile në Aeroportin e Kukësit me gjithë pajisjet e nevojshme”

Detyrat: Sipas shtojces 5 te specifikimeve teknike

Shpërndarja: Sipas shtojces 5 te specifikimeve teknike

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Albcontrol sha

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: *kriteret e mesiperme janë vendosur ne perputhje me Nenin 82 "Formulari permbledhes i vetdeklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertes", te Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe ne mbeshtetje te nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:i ndryshuar citojme Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël", Neni 82, i LPP "1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik".*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, ku xhiroja mesatare vjetore për 3 vitet e fundit financiare (2020,2021,2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 22 199 333 lekë pa tvsh (40% e fondit limit) ose

2.2.2 Bilancet e viteve 2020, 2021 dhe 2022. miratuar nga organet perkatese shteterore. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",i ndryshuar, si dhe në legjislacionin e fushës ne fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës*

elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori Ekonomik të ketë realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit, në vlerën jo më të vogël se 40% të fondit limit.

Shërbimet e ngjashme do të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara dhe të jenë të deklaruara në organet tatimore.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe nenit 41/3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën që AK kërkon të realizojë, prandaj është kërkuar përvojë e ngjashme të jenë në vlerën jo më e madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatat që vërtetojnë përputhshmërinë me standardet:

- **ISO 9001:2015**, Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë ose e perditesuar e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmërisë.
- **ISO 27001-2013**, Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë Informatike ose e perditesuar e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmërisë.
- **ISO 20000-1:2018**, Sistemi për Menaxhimin e Shërbimeve ose e perditesuar e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe të jetë brenda kohës së vlefshmërisë.

Certifikatat duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH, Ose ekuivalente me to.

Argumentim: Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Sqarojmë se Albcontrol sha, operon në një fushë që është shumë specifike “Navigimi Ajror”, sipas rregullores Europiane 1035/2011 dhe të audituar nga ana e Agjensisë Europiane të Sigurisë së Aviacionit (EASA) çdo dy vjet, ndërkohe sistemet me të cilët operon duhet të jenë komptibël me kërkesat e rregullatorëve ndërkombëtare të Aviacionit Civil sipas Rregullores se Komisionit Europian EC 552/2004 si dhe kërkesave të tjera që kanë të bëjnë me sigurinë dhe përputhshmërinë me rregulloret si dhe me sistemet e tjera që janë operative. Albcontrol është gjithashtu i certifikuar, për shkak të natyrës së aktivitetit me ISO 9001:2015, ISO 14001:2015, ISO 45001:2018, ISO 27001:2013, ISO 20000-1:2018, SES (Reg 2017/373).

Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilesor të tij. Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit siguron që operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përfaqje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria.

Menaxhimi i shërbimit IT siguron që operatori ekonomik ka të implementuar një sistem ofrimi të shërbimit përmes të cilit efektivisht planifikon, implementon, operon, monitoron, kontrollon dhe mirëmban portofolin e shërbimeve dhe cilësinë e tyre.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, sipas tabelës në specifikimet teknike, e cila duhet të përmbajë:

- Modelin e Kullës që do të ofrohet (shoqëruar me katalogët përkatës)
- Modelin e sistemeve CNS që do të ofrohet

Argumentim: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar,*

Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë pronësinë ose të drejtën për përdorimin e pajisjes (Kullë e kontrollit mobile) për ofrimin e këtij shërbimi. Dokumentet provuese për disponimin e kullës së kontrollit mobile janë fatura blerje / dokumente zhdoganimi / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontrate dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Argumentimi: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të ekzekutimin e objektit të prokurimit.*

2.3.5. Operatorët ekonomikë për realizimin e kontratës duhet të ketë të punësuar jo më pak se 8 (tetë) punonjes (prej të cilëve të jenë inxhinierët e mëposhtëm) për 3 tre muajt e fundit, kjo e vërtetuar nga Administrata Tatimore dhe shoqëruar me listpagesat për periudhen e mësipërme:

-
- a) Të paktën 1 (një) inxhinier informatik
 - b) Të paktën 1 (një) inxhinier elektronike;
 - c) Të paktën 1 (një) inxhinier teknologji informacioni
 - d) Të paktën 1 (një) inxhinier mekanik
 - e) Të paktën 1 (një) inxhinier elektrik

Kërkesat e mësipërme duhen të vërtetohen me:

Kontratë punë përkatëse

Diplomat përkatëse

Listëpagesat sipas formatit E-Sig 25, të konfirmuara nga Administrata Tatimore që vërtetojnë se punonjësi ka qenë i punësuar pranë operatorit ekonomik 3 (tre) muajt e fundit.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

***Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.*

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë që ka në dispozicion një Help Desk të dedikuar, të kontaktueshëm 24/7/365, e vërtëtuuar me anë të një vetëdeklarimi.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

***Argumentim:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriteret e tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës*

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.

Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

